



Vëllimi 3, Numri 15

Tetor 2022

BULETINI KUNDËR TERRORIZMIT

PËR BALLKANIN, RRETH BALLKANIT

NË KËTË NUMËR

Lajme dhe Informacione kundër terrorizmit 1

Maqedonia e Veriut vë në listën e zezë 15 LHT për financim, rekrutim dhe propagandim të terrorizmit - 2

Gjermania riatdheson 12 shtetar nga Kampi Roj në Siri - 2

Ekspertët e OKB-së paralajmërojnë për kërcënime të reja në financimin e terrorizmit - 2

Raportet e GWU mbi LHT-të e riatdhesuara në Ballkanin Perëndimor — 3



Overseas Prosecutorial
Development, Assistance, and Training

Lajme dhe informacione lidhur me terrorizimin për përditësimin dhe komunikimin mes partnerëve tanë në rajon

Departamenti i Drejtësisë, Zyra e Ndihmës Zhvillimore dhe Trajnimit Prokurorial (OPDAT) në partneritet me Departamentin Amerikan të e Shtetit, Byroja e Antiterrorizmit

Në shtator, Maqedonia e Veriut vendosi kufizime financiare ndaj 15 shtetasve të saj për shkak të mbështetjes së tyre për ISIS-in. Gjithashtu në shtator, një grup ekspertësh të Kombeve të Bashkuara u takuan për të diskutuar shfrytëzimin e teknologjive të reja nga terroristët në sektorin financiar. Në tetor, Gjermania riatdhesoi 12 nga shtetasit e saj të lidhur me ISIS-in nga Siria, ndërkohë që një universitet amerikan publikoi një studim mbi tendencat e dënimeve dhe mbi faktorët e sigurisë që duhen marrë në konsideratë sa u përket LHT-ve të riatdheshuar në Ballkanin Perëndimor.

Tom Saunders
Këshilltar Ligjor kundër Terrorizmit për Ballkanin
OPDAT/DOJ
Ambasada e SHBA, Sarajevë
SaundersTN@state.gov

Jasenska Ferizović
Këshilltare Ligjore
OPDAT/DOJ
Ambasada e SHBA
Sarajevë
FerizovicJ@state.gov

Bledar Bashanović
Specialist Ligjor
OPDAT/DOJ
Ambasada e SHBA
Tiranë
BashanovicB@state.gov

Maqedonia e Veriut vë në listën e zezë 15 LHT për financim, rekrutim dhe propagandim të terrorizmit

Më 19 shtator, Maqedonia e Veriut vendosi kufizime financiare ndaj 15 LHT-ve, rekrutuesve dhe financuesve. Këto kufizime kufizojnë rëndë aftësinë e individëve për të përdorur dhe për të transferuar prona ose për t'u angazhuar në aktivitete biznesi. Kufizimet janë vendosur për një kohë të pacaktuar.

Në mënyrë të veçantë, Maqedonia e Veriut ka vendosur në këtë listë të zezë individët

1. Fadil Rustemi - për rekrutimin dhe financimin e udhëtimit të LHT-ve për në Siri dhe për pjesëmarrje në aktivitetet e ISIS-it gjatë 2015-2016;
2. Azem Latifi - për financimin e udhëtimit të LHT-ve për në Siri dhe për fshehjen e autorëve të veprave penale të terrorizmit;
3. Amir Ismaili - për pjesëmarrje në aktivitetet e ISIS-it;
4. Orhan Ramadani - për pjesëmarrje në aktivitetet e ISIS-it dhe për përhapje të propagandës së terrorizmit në mediat sociale;
5. Orhan Derala - për anëtarësim në ISIS, për rekrutim të LHT-ve nga Maqedonia e Veriut dhe për propagandimin e ISIS-it në mediat sociale;
6. Fitim Ramadani - për anëtarësim në ISIS dhe për përhapje të propagandës së ISIS-it në mediat sociale;
7. Besim Shaqiri - për pjesëmarrje në aktivitetet e ISIS-it;
8. Sadula Zhupani - për anëtarësim në ISIS dhe për përhapje të propagandës së ISIS-it;
9. Elmira Avmedoski - për anëtarësim në ISIS dhe për përhapje të propagandës së ISIS-it;
10. Emir Iseni - për anëtarësim në ISIS dhe për përhapje të propagandës së ISIS-it;
11. Jetmir Ismaili - për anëtarësim në ISIS dhe për përhapje të propagandës së ISIS-it;
12. Adem Kamberi - për pjesëmarrje në aktivitetet e ISIS-it;
13. Nusret Ametov - për pjesëmarrje në aktivitetet e ISIS-it;
14. Abdurrahman Belja - për pjesëmarrje në aktivitetet e ISIS-it; dhe
15. Sulejman Idrizi - për pjesëmarrje në aktivitetet e ISIS-it.

Gjermania riatdheson 12 shtetas nga Kampi Roj në Siri

Në tetor, Gjermania riatdhesoi 12 qytetarë të lidhur me ISIS-in nga kampi Roj në Sirinë verilindore. Në atë grup të kthyerish ishin katër gra, shtatë fëmijë dhe një djalë i ri që ishte dërguar në Siri kur ishte 11 vjeç. Ministria e Jashtme gjermane Annalena Baerbock deklaroi se, përmes këtij riatdhesimi dhe disa të tjerëve të mëhershëm, Gjermania ka kthyer deri tani pothuajse të gjithë shtetasit e saj që mbaheshin të ndaluar në kampet siriane. Megjithatë, disa gra mbeten atje, pasi nuk kishin pranuar të ktheheshin në Gjermani. Pas mbërritjes në Gjermani, pesë personat e riatdhesuar u ndaluan dhe, sipas ministrit Bearbock, ata do të duhet të "përgjigjen për veprimet që akuzohen se kanë kryer" para gjyqësorit gjerman.

Deri më sot, Gjermania ka kryer gjashtë operacione riatdhesuese dhe ka sjellë gjithsej 26 gra dhe 76 fëmijë nga kampet siriane. Shumica e grave të riatdhesuara janë ndjekur penalisht dhe janë dënua nga gjykatat gjermane për krime të lidhura me terrorizmin, si dhe për vepra të tjera penale të bazuara në të drejtën kombëtare dhe ndërkombëtare.

Burimet: [Gjermania riatdheson 12 qytetarë të lidhur me Shtetin Islamik nga Siria](#)

[Gjermania riatdheson 12 shtetas nga kampi xhihadist sirian](#)

Ekspertët e OKB-së paralajmërojnë për kërcënime të reja në financimin e terrorizmit

Terroristët kanë përdorur internetin, mediat sociale dhe teknologjinë për të paktën 20 vjet për të çuar përpara qëllimet e tyre - duke përfshirë përhapjen e propagandës, rekrutimin e anëtarëve të rinj dhe radikalizimin e sulmuesve të ardhshëm. Tashmë, ekspertët e mbledhur nga Kombet e Bashkuara paralajmërojnë se terroristët po keqpërdorin teknologji të reja dhe në zhvillim për të shfrytëzuar sektorin

e shërbimeve financiare, duke e komplikuar luftën kundër financimit të terrorizmit.

Në shtator, më shumë se 20 ekspertë u takuan për të diskutuar se si terroristët shfrytëzojnë teknologjitë e reja dhe ato në zhvillim e sipër. Këto takime u drejtuan nga Drejtoria Ekzekutive e Komitetit të Kombeve të Bashkuara Kundër Terrorizmit (CTED), duke sjellë së bashku ekspertë nga organizatat ndërkombëtare dhe rajonale, autoritetet kombëtare, shoqëria civile, akademia, dhe sektori privat.

Gjatë takimeve të udhëhequra nga CTED, ekspertët u përqendruan në dy ide kryesore. Ata identifikuan trendet

globale dhe rajonale se si terroristët shfrytëzojnë teknologjitë e reja të pagesave dhe metodat e mbledhjes së fondeve. Ata gjithashtu hulumtuan se si teknologjitë e reja mund të përmirësojnë përpjekjet për të luftuar financimin e terrorizmit

Teknologjitë në zhvillim mund të përdoren për të kërkuar donacione për organizatat terroriste, për të shitur mallra online me fitime që shkojnë në rrjetet terroriste, dhe për të ashtuqajturin crowdfunding për grupet që paraqiten si organizata bamirëse ose si organizata humanitare, por që në fakt janë maskime të grupeve terroriste. Për të mbështetur këto aktivitete, terroristët po përdorin sisteme të pagesave me telefon dhe kriptovaluta si Bitcoin. CTED paralajmëron se zbatimi i masave AML/CFT është duke u bërë gjithnjë e më sfidues për shkak të rritjes së financave të decentralizuara (DeFi), NFT-ve, dhe portofoleve pa hostim të kriptovalutave.

Për të adresuar këtë kërcënim, shtetet duhet të miratojnë rregullat e duhura financiare që mbulojnë këto aktivitete. Përveç kësaj, forcat e zbatimit të ligjit, prokurorët dhe

gjyqtarët duhet të informohen për këto tendenca të reja. Ata duhet t'i njohin sa duhet teknologjitë e reja që të jenë në gjendje t'i identifikojnë dhe që ta godasin në mënyrë efektive veprimtarinë kriminale në këtë sektor.

Ekspertët e udhëhequr nga CTED këshillojnë që zyrtarët e qeverisë të krijojnë partneritete të fuqishme publik-privat, duke përfshirë edhe një “dialog midis njësisë të inteligjencës financiare dhe sektorit përkatës të teknologjisë financiare (FinTech) në lidhje me... raportimin e aktiviteteve të dyshimta

Megjithëse teknologjitë e reja krijojnë rreziqe, ato kanë edhe potencialin që t'i bëjnë masat e AML/CFT “më të shpejta, më pak të kushtueshme dhe më efikase”. Për ta kuptuar këtë potencial, zyrtarët e qeverisë duhet të marrin iniciativën dhe të shfrytëzojnë fuqinë e teknologjive financiare në zhvillim.

Burimi: [Sesionet e teknologjisë së CTED: Pikat kryesore mbi “Kërcënimet dhe mundësitë që lidhen me teknologjitë e reja të pagesave dhe metodat e mbledhjes së fondeve” | Këshilli i Sigurisë - Komiteti Kundër Terrorizmit \(CTC\)](#)

Raportet e GWU për LHT-të e riadhesuar në Ballkanin Perëndimor

Në shtator, Programi për Ekstremizmin i Universitetit George Washington publikoi një raport ku analizoheshin riadhesimet e luftëtarëve të huaj terroristë meshkuj (LHT) në Bosnje-Hercegovinë (BiH), Kosovë, dhe në Maqedoninë e Veriut. Në atë raport diskutohen tendencat në ndjekjen penale dhe në dënimin e LHT-ve në këto vende, si dhe sfidat dhe konsideratat e politikave për adresimin e rreziqeve të sigurisë që lidhen me LHT-të e riadhesuara, si brenda sistemit korrektues ashtu edhe pas lirimit të LHT-ve nga burgu.

Sipas këtij raporti, nga gushti 2018 deri në qershor 2022, këto tre vende të Ballkanit Perëndimor riadhesuan gjithsej 31 meshkuj të lidhur me ISIS-in, që mbaheshin të ndaluar më parë nga forcat kurde në Siri. Të paktën 24 prej tyre janë proceduar penalisht me sukses sipas ligjeve që e parashikojnë si veprë penale anëtarësimin në organizata terroriste dhe udhëtimin jashtë vendit për qëllime terrorizmi.

Maqedonia e Veriut, që ishte vendi i parë evropian që transferoi publikisht LHT-të nga Siria, ka riadhesuar 11 LHT meshkuj në moshë madhore. Sipas raportit, të paktën shtatë prej tyre janë dënuar nga gjykatat e Maqedonisë së Veriut, ndërsa pjesa tjetër është nën aktakuzë. Dënimet e vendosura në këto raste shkonin nga gjashtë deri në nëntë vjet, me një dënim mesatar prej 6.4 vjet.

Kosova ka riadhesuar 12 LHT. Sipas raportit, të paktën 10 prej tyre janë dënuar dhe dy janë nën hetim. LHT-të e dënuara në Kosovë u dënuan me tre deri në gjashtë vjet burg, me një dënim mesatar prej katër vjetësh. BiH riadhesoi tetë LHT, të cilët janë ndjekur penalisht dhe janë dënuar. Dënimet në këto raste shkonin nga një deri në gjashtë vjet, me një dënim mesatar me burg prej 3.4 vjet.

Raporti vëren se dënimet me burg ndaj LHT-ve të dënuara në këto tri vende të Ballkanit Perëndimor janë dukshëm më të ulëta se dënimet e dhëna për vepra të ngjashme në vendet

e Bashkimit Evropian ose në Shtetet e Bashkuara, ku dënimi mesatar me burg ka qenë përkatësisht 9 dhe 13.1 vjet. Megjithatë, vërehet gjithashtu se dënimet për LHT-të e riadhesuara kanë qenë, në tërësi, më të gjata se dënimet e dhëna për aktivitete të tjera të lidhura me ISIS-in.

Dënimet në BiH dhe në Kosovë vazhdojnë të kufizohen me minimumet statutoare. Raporti konstaton se kjo lehtësi është e pazakontë duke pasur parasysh se LHT-të e riadhesuara kanë luftuar krah ISIS-it për një kohë shumë më të gjatë dhe kanë treguar në këtë mënyrë “angazhim më të fuqishëm ndaj kauzës së organizatës” sesa individët e tjerë që janë kthyer vullnetarisht në vitet e mëparshme. Për më tepër, ata shpesh kanë udhëtuar për në Siri “me paramendim dhe si pjesë e një grupi individësh me mendim të ngjashëm, ose në koordinim me rrjetet xhihadiste që vepronin midis Ballkanit Perëndimor dhe Sirisë”, që është një tregues tjetër i vendosmërisë dhe qëllimit të tyre. Në këtë drejtim, raporti vlerëson se autoritetet duhet të rivlerësojnë dhe të përshtatin shkallët e dënimit para se të ndodhin riadhesime të tjera në të ardhmen.

Sipas raportit, LHT-të e burgosur paraqesin rrezik të lartë për sigurinë e burgut, pavarësisht numrit të vogël të tyre, për shkak të lidhjeve të tyre me rrjetet terroriste dhe përvojës së tyre në fushën e betejës. Prandaj, vendet duhet të investojnë më shumë burime në zhvillimin e mjeteve të vlerësimit të rrezikut të bazuar në dëshmi dhe një strategji efektive për menaxhimin e rrezikut për të parandaluar radikalizimin në burg dhe rekrutimin e të burgosurve të tjerë. Duke pasur parasysh se shumica e LHT-ve do të lirohen nga burgu midis viteve 2023 dhe 2025, raporti këshillon që autoritetet të “nxisin përpjekjet e shkëputjes dhe të rehabilitimit në burg, dhe të zbatojnë mjete shtesë të vlerësimit të rrezikut dhe të menaxhimit në përgatitje për rikthimin e tyre në shoqëri”.

Burimi: [A. shtuni Ballkani Perëndimor: Luftëtarë Terroristë të Huaj të Riadhesuar, Trendet e Dënimeve dhe Konsideratat e Sigurisë](#)